

Kompensimi i detyrimeve me tepricat kreditore

Tatimpaguesit që kanë tepricë kreditore të TVSH-së ose të një tatimi tjetër përfitojnë nga fshirja/shuarja e detyrimeve tatimore, pas kompensimit (zvogëlimit) të tepricës kreditore deri në masën e tatimit principal të papaguar.

Kur teprica kreditore nuk mbulon vlerën e plotë të tatimit të papaguar, tatimpaguesi duhet të kryej pagesën e pjesës së mbetur të tatimit të papaguar në mënyrë që të përfitojë nga fshirja e dënimeve administrative.

Kompensimi i tepricës kreditore me detyrimin tatimor të papaguar, zbatohet pa kontroll paraprak të tepricës kreditore nga Administrata Tatimore.



Ndërprerja e masave të mbledhjes me forcë nga Administrata Tatimore

Për detyrimet tatimore të papaguara që fshihen/shuhet, Administrata Tatimore ndërpret procedurat e mbledhjes me forcë sipas këtij ligji.

Detyrimet tatimore të papaguara në proces ankimimi

Për të përfitur nga fshirja e detyrimeve tatimore të papaguara të cilat janë në proces ankimimi administrativ ose gjyqësor, tatimpaguesi duhet të heqë dorë nga ankimi administrativ ose gjyqësor në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës administrative kompetente.

www.tatime.gov.al



DREJTORIA E
PERGJITHSHME
E TATIMEVE

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI NË
www.tatime.gov.al,
drejtoheni në sportelet e shërbimit ndaj
tatimpaguesve në çdo Drejtori Rajonale Tatimore,
ose telefononi në numrin pa pagesë:

0800 00 02

të Qendrës së Thirrjeve pranë Drejtorisë së
Përgjithshme të Tatimeve.

ADRESA:

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Rruga Gjin Bue Shpata, Tirana 1000, Albania

DENONCIME:

0800 14 14

FALJA/FSHIRJA E DETYRIMEVE TATIMORE

Tatimpaguesit që nuk përfitojnë
Detyrimet tatimore që fshihen pa kusht
Detyrimet tatimore që fshihen me kusht
Raste të tjera të përfitimit nga fshirja e detyrimeve
Detyrime tatimore që nuk përfitojnë nga fshirja
Kompensimi i detyrimeve me tepricat kreditore
Ndërprerja e masave të mbledhjes me forcë nga administrata tatimore
Detyrimet tatimore të papaguara në proces ankimimi

FALJA/FSHIRJA E DETYRIMEVE TATIMORE

Bazuar në Ligjin Nr. 33/2017, datë 30.3.2017, të gjithë tatimpaguesit e regjistruar në regjistrin aktiv, pasiv ose të çregjistruar që kanë detyrime tatimore të papaguara ndaj Administratës Tatimore qendrore e vendore, mund të përfitojnë nga fshirja/falja sipas kushteve të përcaktuara në ligj.

Tatimpaguesit që nuk përfitojnë

Tatimpaguesit e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën tatimore, në kuptim të legjislacionit të fushës, nuk mund të përfitojnë nga fshirja/falja e detyrimeve tatimore të papaguara.

Detyrimet tatimore që fshihen pa kusht

Detyrime tatimore të papaguara janë tatimi, kamatëvonesa dhe çdo dënim administrativ i lidhur ose jo me tatimin e papaguar.

Fshihen/shuhen detyrimet tatimore të papaguara, që i përkasin periudhave tatimore 31.12.2016 e më parë dhe që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e subjektit deri në 31.12.2016, përveç kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Fshihen/shuhen dënimet administrative (gjobat) dhe kamatëvonesat për sigurimet shoqërore e shëndetësore që i përkasin periudhave tatimore

Dhjetor 2010 e më parë, që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e subjektit.

Detyrimet tatimore që fshihen me kusht

Fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën 06.05.2017, të regjistruara në llogarinë e tatimpaguesit, me kushtin që, brenda datës 31.12.2017, të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi për:

- detyrimet tatimore, që u përkasin periudhave tatimore Janar 2011- Dhjetor 2014;
- kontributet e sigurimeve, që u përkasin periudhave tatimore Janar 2011 - Dhjetor 2014;
- taksat/tarifat vendore të papaguara, që u përkasin periudhave tatimore Janar 2011 - Dhjetor 2014.

Për të përfituar nga fshirja e gjobave dhe kamatëvonesave të mësipërme, që rezultojnë të papaguara në datën 06.05.2017, tatimpaguesit duhet të paguajnë të plotë tatimin/taksën/tarifën/kontributin e papaguar të periudhës përkatëse tatimore.

Raste të tjera të përfitimit nga fshirja e detyrimeve

Fshihen detyrimet tatimore, për tatimpaguesit që rezultojnë të çregjistruar në QKB me vendim gjykate apo që janë të çregjistruar në

Administratën Tatimore deri në datën 06.05.2017.

Fshihen dënimet administrative tatimore të llogaritura automatikisht nga sistemi për deklarim të vonuar, sipas nenit 113, të ligjit nr. 9920, datë 19.8.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, deri më 31.12.2016, përfshirë edhe dënimet që lidhen me afatin e deklarimit të të punësuarve;

Fshihen dënimet administrative për dorëzim të vonuar të vendimit për destinimin e rezultatit dhe dorëzim me vonesë të pasqyrave financiare të aplikuara,

Fshihen dënimet administrative për mosdeklarim në afat, për deklarata të padorëzuara, me kusht që çdo deklaratë e padorëzuar të dorëzohet deri në datën 30.6.2017;

Fshihen dënimet administrative (gjobat) si rezultat i aplikimit të dispozitave të ligjit nr. 99/2015, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.8.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese;

Detyrime tatimore që nuk përfitojnë nga fshirja

Nuk përfitojnë nga fshirja të gjitha dënimet administrative të vendosura nga Administrata Tatimore në raste të konstatimit të shkeljeve të procedurave tatimore, si për moslëshim kuponi tatimor, për mosregjistrim të të punësuarve, për pengim të kontrollit tatimor, etj.